



NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar i kolegjit, Valdete Daka dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Mirlinda Mejzini Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurve S. Z. dhe E. Z., për shkak të dyshimit të bazuar se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “*Detyrimi*”, nga neni 328, paragrafi 2., lidhur me nenin 31, e lidhur me nenin 77. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), ndërsa i pandehuri S. Z. edhe për veprat penale “*Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm*”, nga neni 367, paragrafi 2., lidhur me nenin 77. të KPRK-së, “*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*”, nga neni 366, paragrafi 1. të KPRK-së dhe “*Cenim i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve*”, nga neni 197, paragrafi 5., lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit S. Z., të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPR.nr.892/23 të datës 03.08.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1DP.nr.1203/2023 të datës 14.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 06.09.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit S. Z., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPR.nr.892/23 të datës 03.08.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1DP.nr.1203/2023 të datës 14.08.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, me aktvendimin PPR.nr.892/23 të datës 03.08.2023 pandehurve S. Z. dhe E. Z., për shkak të dyshimit të bazuar se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “*Detyrimi*”, nga neni 328, paragrafi 2., lidhur me nenin 31, e lidhur me nenin 77. të KPRK-së, ndërsa i pandehuri S. Z. edhe për veprat penale “*Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm*”, nga neni 367, paragrafi 2., lidhur me nenin 77. të KPRK-së, “*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*”, nga neni 366, paragrafi 1. të KPRK-së dhe

“Cenim i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve”, nga neni 197, paragrafi 5., lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së, ia ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, ashtu që sipas këtij aktvendimi, paraburgimi do t’iu llogaritet nga data 04.08.2023 e deri me datën 03.10.2023. Të pandehurit paraburgimi iu është vazhduar konform dispozitës së nenit 184, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1., e 1.2., pikat 1.2.1., 1.2.2. dhe 1.2.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PN1DP.nr.1203/2023 të datës 14.08.2023, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtëses të të pandehurve dhe ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit S. Z., avokat Skender Musa, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe për shkak të caktimit të masës së paraburgimit, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë në tërësi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anulojë aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe të pandehurit t’ia ndërprejë paraburgimin dhe të caktojë një masë më të butë për sigurimin e pranisë së të pandehurit.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.187/23 e datës 01.09.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, mbrojtësi thekson se nuk ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprat penale, ky dyshim duhet të mbështetet në fakte për secilën vepër veç e veç e të cilat të shtjellohen në aktvendim e jo vetëm të përmenden disa prova, dyshimi i bazuar duhet të mbështetet në prova të artikulueshme, aktvendimet duhet të paraqesin qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, prandaj nuk është përmbushur elementi kryesor i veprës penal dyshimi i bazuar se i pandehuri i ka kryer veprat penale, se gjykatat nuk kanë treguar se në cilat do të ndikojë i pandehuri, e sa nuk ka argumentuar rrezikun e përsëritjes së veprës penale, ndërsa sa i përket rrezikut të ikjes, mbrojtësi pretendon se në praktikë, për veprat penale të cilat i vihen në barrë të pandehurit, nuk vazhdohet paraburgimi, por kanë pasur mundësi tjera për sigurimin e të pandehurit në procedurë siç është ndalimi për t’iu afruar personit apo vendit të caktuar, masa e paraqitjes në stacionin policor, e jo duke e zbatuar masën më të rëndë. Tutje, mbrojtja pretendon se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë kanë bërë shkelje esenciale të dispozitave të nenit 5 të KPP-së, sepse nuk kanë arritur të sigurojnë një gjykim të drejtë dhe të

paanshëm, e gjithashtu kanë bërë shkelje të nenit 7, paragrafi 1. dhe 2. të KPP-së, sepse gjykatat, prokuroria dhe policia janë të detyruar që saktësisht dhe në tërësi të vërtetojnë faktet që janë të rëndësishme për marrjen e një vendimi të ligjshëm.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk janë të bazuara, ngase nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprat penale të cilat i vihet në barrë dhe se a do të argumentohen këto fakte është çështje që do të vlerësohet dhe vërtetohet gjatë fazave të mëtutjeshme të procedurës. Andaj, kjo gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184 paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. të KPP-së.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2., pika 1.2.1. të KPP-së, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, duke pasur parasysh faktin se veprat penale për të cilat dyshohet janë të natyrës mjaft të rëndë, për të cilat, nëse i njëjti shpallet fajtor, parashihet dënim mjaft i lartë, andaj me gjetjen e tij në liri i njëjti do të mund të arratiset me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, e në këtë mënyrë do ta pamundësonte zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Po ashtu, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2., pika 1.2.2. të KPP-së, sepse me gjetjen e të pandehurit në liri i njëjti mund të fsheh, ndryshojë, ose falsifikojë provat e veprës penale, si dhe të pengoj rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarët të cilët ende nuk janë dëgjuar, të dëmtuarit që të dëshmojnë në favor të tij, si dhe duke ndikuar në bashkëkryerësit tjerë me qëllim të koordinimit të deklaratave dhe të përgatitjes së mbrojtjes në favor të tij, andaj këto rrethana arsyetojnë frikën se me lënien e të pandehurit në liri mund të vijë deri te pengimi i rrjedhës normale të procedurës penale.

Gjithashtu, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit edhe konform nenit 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2., pika 1.2.3. të KPP-së, duke pasur parasysh peshën e veprave penale, mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprave penale, vazhdimësia e kryerjes së veprave penale ndaj viktimës së njëjtë, rrethanat në të cilat janë kryer veprat penale janë karakteristikë personale e të pandehurit marrë parasysh sjelljet e tij të mëparshme, kanosja të cilën e ka bërë, acarimi i raporteve me të dëmtuarin, koordinimi për kryerjen e veprave penale me bashkëkryerësit tjerë, si dhe gjatë ndërmarrjes së veprimeve ka treguar vendosmëri dhe shkallë të lartë të dashjes në kryerjen e veprave penale, prandaj masa e paraburgimit është e vetmja masë preventive dhe adekuate për zbatimin e drejtë të procedurës penale.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, si dhe në

bazë të vlerësimit të tillë kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, ndërsa masat tjera alternative janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës të të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.451/2023, më datë 06.09.2023

Bashkëpunëtore profesionale,
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetar i kolegjit,
Afrim Shala